



REPUBLICA E SHQIPERISË  
MINISTRIA E FINANCAVE  
MINISTRI

1519/1

**URDHËR**

Nr. 11/1, Datë 2.02.2012

**“PËR PARAQITJEN E DOKUMENTACIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E  
KANDIDATIT PËR KONSULENT QË DO OFROJË ASISTENCË GJATË  
PËRZGJEDHJES SË FITUESIT PËR LOTARINE KOMBËTARE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutes, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.25, datë 11.01.2012, “Për miratimin e kritereve të vlerësimit të garës, të dokumentave standarde dhe strukturës së Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve për dhënien e licencës për lotarinë kombëtare”, dhe në vijim të Urdhërit nr.11, datë 31.01.2012, “Për ngritjen e grupit teknik që do të propozojë konsulentin i cili do të ofrojë asistencë gjatë përzgjedhjes së fituesit për lotarinë kombëtare”, Ministri i Financave,

**URDHËRON:**

1. Shpalljen e kërkesës për kontraktimin e një konsulenti të huaj ndërkombëtar që do asistojë Autoritetin gjatë procedurës për përzgjedhjen e fituesit për lotarinë kombëtare.
2. Kandidatët duhet të jenë shoqëri konsulence me eksperiencë në fushën për të cilën kërkohet konsulencia në zbatim të pikës 3 të urdhërit nr.11, datë 31.01.2012 të Ministrisë të Financave.
3. Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumenta:
  - a. Një përshkrim të konsulentit, i cili duhet të tregojë identitetin e plotë, adresën e saktë, numrin e telefonit dhe të faksit, adresën e emailit, si dhe një përmbledhje të CV-ve të stafit përgjegjës për ofrimin e shërbimeve;
  - b. Një përshkrim të aftësive intelektuale dhe profesionale;
  - c. Përvojën e mëparshme për dhënien e shërbimeve për të cilat kërkohet dhënia e konsulencës. (shoqëruar me dokumentacionin provues, kontrata të ngjashme ose vertetime etj);
  - d. Tarifën për dhënien e konsulencës.

4. Kandidatët duhet të jenë të regjistruar në regjistrat përkatës profesionalë ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor.
5. Kandidati duhet të paraqesë dokumenta që vërtetojnë se nuk është dënuar për shkelje penale, nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional, qe kapitalet/asetet e (subjektit tuaj) nuk janë në duart e përmbaruesit gjyqsor apo ekziston një urdhër sekuestroje për to, leshuar nga autoritetet kompetente.
6. Gjuha e dokumentacionit është anglishtja.
7. Dokumentat duhet të dërgohen në format elektronik në adresën e emailit: [ikoka@minfin.gov.al](mailto:ikoka@minfin.gov.al) ose me postë (origjinale ose fotokopje e noterizuar), pranë Kryetarit të Grupit Teknik.
8. Afati i dorëzimit të dokumentacionit është deri në **datë 29 Shkurt 2012**, brenda orarit zyrtar të punës. Dokumentat e dorëzuara pas këtij afati nuk merren në shqyrtim.
9. Dokumentacioni do të hapet dhe shqyrtohet nga grupi teknik i cili do të vleresoje dokumentacionin e paraqitur dhe do të propozojë Ministrit miratimin e fituesit. Fituesi do të njoftohet zyrtarisht dhe do publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave.
10. Ngarkohet Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit për publikimin e këtij urdhëri në faqen zyrtare të internetit të Ministrisë së Financave deri në afatin e përcaktuar në pikën 8 të këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**RIDVAN BODE**

**MINISTER**

